



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

---

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 10**

**Prishtinë, më 20.2.2018, në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Igor Simiq, kryetar i komisionit, Xhelal Sveçla e Danush Ademi zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, Duda Balje Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetović, (OSBE), Zijush Ahmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Emrat e stafit mbështetës të komisionit:** koordinatorë - Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu-zyrtare e lartë e fushës.

**Mbledhjen e kryesoi: Igor Simiq,** kryetari i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më; 19.1.2018 dhe 7.2.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, me amendamente të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa;
5. Inicimi i Komisionit për nismën legjislative të Projektligjit për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës;
6. Formimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i komisionit;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

*Kryetari*, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më; 19.1.2018 dhe 7.2.2018**

*Kryetari*, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më: 19.01.2018 dhe 7.2.2018, pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**

*Kryetari*, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, komisioni nxori këtë:*

### **Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe konstatoi se Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

## **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa**

*Kryetari*, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:*

### **Rekomandim**

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, dhe konstatoi se Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

## **5. Inicimi i Komisionit për nismën legislative të Projektligjit për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës**

*Kryetari*, tha se në bazë të nenit 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 53 të Rregullores së punës së Kuvendit, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka të drejtë të iniciojë nisma legislative. Nisma legislative për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, është propozuar nga deputeti Veton Berisha.

*Veton Berisha*, theksoi se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës ka një bazë ligjore dhe është e domosdoshme të plotësohet me arsy që ditët memoriale të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Ai kërkoi të marr mbështetjen e plotë nga ana e Komisionit që të fillohet me hartimin e Ligjit për Festat Zyrtare, gjegjësisht të amendamentohet neni 5.5 me qëllim që në 'Ditën Memoriale' të shtohet '24 Qershori', ditë e egjiptianëve.

*Komisioni u pajtua në formë unanime për nismën legislative të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe nxori këtë:*

### **Përfundim**

- a) Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim do të hartojë Projekt -ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare, propozuar nga deputeti Veton Berisha;
- b) Formohet Grupi punues në këtë përbërje: kryesuesi Veton Berisha – anëtarët tjerë: Xhelal Sveçla, Mufera Serbia Shinik, Danush Ademi dhe Sasha Milosavljeviq;
- c) Anëtarët e komisionit, në bazë të interesimit, mund t'i bashkëngjiten Grupit punues gjatë punës së tij;
- d) Grupi punues, në bashkëpunim me Njësinë për koordinimin e komisionit, do të hartojë Raportin e shkruar, për shqyrtim dhe miratim në Komision dhe të procedohet më tej.

## **6. Formimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i komisionit**

*Kryetari*, informoi anëtarët e komisionit për procesin e mbikëqyrjes së ligjeve të cilat janë të përcaktuara në bazë të Planit të punës së Komisionit për vitin 2018. Ai propozoi të formohen grupet punuese për mbikëqyrjen e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal (nga aspektit i kontrollit për buxhet).

Pas konsultimeve, Komisioni emëroi kryetarin dhe anëtarët e grupeve punuese, dhe nxori këtë:

### **Përfundim**

#### **I. Përbërja e Grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për vetëqeverisjen lokale:**

1. Zoran Mojsilović, kryesues
2. Danush Ademi, anëtar
3. Mufera Serbica Shinik, anëtare
4. Duda Balje, anëtare dhe
5. Albert Kinolli, anëtar.

#### **II. Përbërja e Grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal (nga aspektit i kontrollit për buxhet).**

1. Duda Balje, kryesuese
2. Xhelal Sveçla, anëtar dhe
3. Jasmina Zhivković, anëtare.

## **7. Të ndryshme**

*Veton Berisha*, propozimi i tij konkret ishte që të ftohet ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës, të raportojë lidhur me çështjen e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në shërbimin policor dhe gradimi i tyre. Në një takim të veçantë, të ftohet ministri i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale me qëllim të raportojë lidhur me punësimin e komuniteteve joshumicë.

*Kryetari*, theksoi se komisioni në vazhdimësi zbaton detyrat dhe obligimet të cilat janë të përcaktuara me planin e punës, për vitin 2018.

Në bazë të diskutimeve, komisioni u pajtua njëzëri, dhe nxorën këtë:

### **Përfundim**

Komisioni, në takimin e radhës do të caktojë datat për të ftuar ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale, me temat e propozuara më lart. Për realizimin e mbajtjes së mbledhjes, do të njoftoheni me kohë.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:50.*

*Përgaditur nga stafi mbështetës i Komisionit*

**Kryetar i komisionit,**

---

**Igor Simiq**